

**AKT THEMELIMI
I SHOQERIS ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA**

“ZDRAVA FOOD” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 16/06/2022, Themeluesi:

1. **Riza Faik Sinanaj**, lindur në Kucove me 15/06/1996, banues në Lushnje, lagjia "18 Tetori", rruga "Andrea Papaj", me leternjoftim nr personal J60615113H.

Deklaron se ka vendosur të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 1-Emërtimi
Emërtimi i shoqërisë është

“ZDRAVA FOOD” sh.p.k

Emri tregtar i shoqërisë : “ZDRAVA FOOD” SHPK

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëhërë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Lushnje, ne lagjen "Gafurr Muco" Zona Kadastrale 8572, Nr Pasurie 14/59/1 me Siperfaqe 2358m2.



Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Regjistrimit.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

1. Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë: Import-Eksport të artikujve ushqimorë, bujqësorë dhe industriale.

Neni 5- Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njëqind) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100 (njëqind) leke.

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njëqind) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100 (njëqind) leke.


Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesiperm është nënshkruar dhe shlyer teresisht në të holla nga ortaku i shoqërisë perkatesisht:

- Riza Faik Sinanaj**, lindur në Kucove me 15/06/1996, banues në Lushnje, lagjia "18 Tetori", rruga "Andrea Papaj", me letërnjoftim nr personal **J60615113H**, vlera e kapitalit të përgjithshëm **100** Leke, numri i pjesëve 1, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë perkundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë



Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i vetëm i shoqërisë është Z Riza Faik Sinanaj**, lindur në Kucove me 15/06/1996, banues në Lushnje, lagjia "18 Tetori", rruga "Andrea Papaj", me leternjoftim nr personal J60615113H.
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyrë të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.



Parë dhe miratuar në Tirane , më 16/06/2022.

ORTAKU E SHOQERISE

Riza Sinanaj

Riza Sinanaj
